



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik "Viante Konstruksion" sh.p.k**

**Adresa: Elbasan Gramsh SPORTI.**

### **FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Procedura e prokurimit: "Kërkesë për Propozim" "Ndërtim i rrugës së shkollës 9-vjeçare "Ymer Kurti", fshati Lagje e Re".**

**Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-10484-02-25-2019**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: "Ndërtim i rrugës së shkollës 9-vjeçare "Ymer Kurti", fshati Lagje e Re".**

**Fondi limit: 10,208,591.54** (dhjetë milionë e dyqind e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, miratuar me VKB Nr. 159 datë 21.12.2018, "Për Miratimin e Programit buxhetor afatmesëm 2019-2021", dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019".

**Kohëzgjatja e kontratës:** 12 (dymbëdhjetë) javë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.03.2019, ora 11:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 9 datë 04.03.2019.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik "Eurondërtimi 2000" shpk** NUIS K020030010

Vlera e ofertës = **7,274,125.36** (shtatë milion e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e njëzetë e pesë pikë tridhjetë e gjashtë ) lekë pa TVSH.

2. **Operatori ekonomik "Neal 86" shpk** NUIS K04814851T

Vlera e ofertës = **7,797,054.68** (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

3. **Operatori ekonomik "Viante Konstruksion" shpk** NUIS K47103804L

Vlera e ofertës = **8,962,458.60** (tetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë ) lekë pa TVSH.

#### 4. Operatori ekonomik "Inerti" shpk

NUIS J66926804L

Vlera e ofertës = **9,445,253** (nëntë milion e katërqind e dyzetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

#### 5. Operatori ekonomik "Kacdedja" shpk

NUIS K51712017A

Vlera e ofertës = **9,486,297.15** (nëntë milion e katërqind e dyzetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

### Janë skualifikuar operatorët ekonomik të mëposhtëm:

#### Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

#### 1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Neal 86" shpk

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **7,797,054.68** (shtatë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për stafin teknik, rezulton se Inxhinieri i Mjedisit i deklaruar nga Operatori ekonomik "Neal-86" shpk nuk është i pajisur me Çertifikatë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Gjithashtu Operatori ekonomik "Neal-86" shpk rezulton se nuk ka të punësuar pranë shoqërisë 1 (një) punonjës hidraulik, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8 ku përcaktohet se: *"Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si më poshtë:*
  - 2 (dy) punonjës elektrikist
  - 1 (një) punonjës teknik ndërtimi
  - 2 (dy) punonjës hidraulik

*Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; deshmite e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit."*

- Operatori ekonomik "Neal-86" shpk nuk ka paraqitur Liçencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17.

#### 2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "Inerti" shpk

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **9,445,253** (nëntë milion e katërqind e dyzetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

- Operatori ekonomik "Inerti" sh.a për të provuar përvoje të sukseshme punë ka

paraqitur tre kontrata me objekt si më poshtë:

1. “Ndërtim Objekti Rezidencial shume Katesh”,
2. **Ndërtim I bazes prodhuese Faza I-re, Shkolla Industriale “Arben Broci” Shkoder.**
  - a. **Rikonstrukcion I ndërtesës së shkollës Teknologjike “Hamdi Bushati” Shkodër**, të cila nuk përkojnë me objektin që po prokurohet, cka bie në kundërshtim me pikën 1, gërma “a” të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit, ku kërkohet që Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin: *“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: : 5,104,296 (pesë milion e njëqind e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit” ....*

### 3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

Çmimi total i ofertës pa TVSH = **9,486,297.15** (nëntë milion e katërqind e dyzetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullim dhe transportim të mbetjeve që kanë ndikim në mjedis (Kodi III.2.B)” pasi nuk ka paraqitur këtë Çertifikatë.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 56 dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66, pika 5, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, referuar formulës së përcaktuar në dokumentat e tenderit, verifikoi nëse ofertat e vlefshme janë me çmim Anomalisht të Ulët nga ku rezultoi se oferta e operatorit ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk është në kushtet e Ofertës Anomalisht të Ulët. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në datë 18.03.2019 i kërkoi operatorit ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk të dërgojë me shkrim brenda datës 21.03.2019 ora 12:00, shpjegime për elementët e ofertës, në lidhje me zërat e preventivit të ofertës së paraqitur në tender, për të cilat kërkohet analizë kosto. Në rast të mosparaqitjes së këtij informacioni brenda datës 21.03.2019 ora 12:00, oferta e operatorit ekonomik do të konsiderohej e papranueshme.

Sa me sipër nga ana e operatorit ekonomik nuk u dorezua analiza e koston dhe sqarimi për ofertën anomalisht të ulët, në formë shkresore pranë Bashkinë Tiranë dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pas vlerësimit të bëre vendosi mospranimin e ofertes ekonomike dhe s’kualifikimin e operatorit ekonomik.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Viantë Konstruksion” sh.p.k**, me adresë: **Elbasan Gramsh SPORTI**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **8,962,458.60** (tetë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Neni 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 13569 Prot. datë 27.03.2019 (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim i rrugës së shkollës 9-vjeçare “Ymer Kurti”, fshati Lagje e Re”**.

Me marrjen e ankesës nga Operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 8999/3 Prot. dt. 27.03.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni i prokurimit publik. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 8999/4 Prot. datë 27.03.2019 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Shoqërisë “Eurondërtimi 2000” shpk konkludoi në mos pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresën me Nr. 13569/2 Prot. , datë 02.04.2019, (administruar në dosjen e prokurimit).

